

Projekti Elektrik i Kontenierit

1. Pajisjet dhe Lidhjet Elektrike

- **Lavatriçet (3x)** – Secila lidhet në një linjë të veçantë me siguresë automatike 16A dhe përcjellës elektrik me seksion 2.5mm².
- **Tharëset e rrobave (2x)** – Secila lidhet në një linjë të veçantë me siguresë automatike 16A dhe përcjellës elektrik me seksion 2.5mm².
- **Bojleri i ujit (2kW)** – Lidhje me një linjë të veçantë dhe siguresë automatike 16A, me përcjellës elektrik 2.5mm².
- **Aspiratori** – Lidhje me linjë të veçantë dhe siguresë automatike 6A, me përcjellës elektrik 1.5mm².
- **Ndriçimi** – Dy llamba LED të komanduar nga dy çelësa (të vendosur pas derës). Lidhja realizohet nëpërmjet 2 linjave të dedikuara me siguresë automatike 6A dhe përcjellës elektrik 1.5mm².
- **Prizat e shërbimit (4x)** – Lidhje me 2 linja të veçanta me siguresë automatike 16A secila dhe përcjellës elektrik me seksion 2.5mm².
- **Lavastovilje (2x)** – Secila lidhet në një linjë të veçantë me siguresë automatike 16A dhe përcjellës elektrik me seksion 2.5mm².

2. Paneli Elektrik

Paneli elektrik do të përmbajë:

- **Sinjalizues 3fazor që sinjalizon prezencën e tensionit në secilën fazë.**
- **Siguresë Automatike MCB**
- **Siguresë diferenciale RCD 30mA 40A** për mbrojtje nga rrymat e rrjedhjes.
- **Siguresa automatike për secilën linjë:**
 - 3x16A për lavatriçet (me përcjellës 2.5mm²)
 - 2x16A për tharëset (me përcjellës 2.5mm²)
 - 1x10A për bojlerin (me përcjellës 2.5mm²)
 - 1x6A për aspiratorin (me përcjellës 1.5mm²)
 - 1x6A për ndriçimin (me përcjellës 1.5mm²)
 - 2x16A për prizat e shërbimit (me përcjellës 2.5mm²)
 - 2x16A për lavastoviljet (me përcjellës 2.5mm²)

3. Rruga e Përcjellësit Elektrik

- **Vendosja e kuadrit elektrik:**
- Kuadri do të vendoset në pozicion të qendrës për akses të lehtë.
- **Rruga e kablllove:**
 - Të gjitha kabllot do të kalojnë përmes tubave PVC të montuar sipërfaqësisht sipas nevojës.

- Linjat kryesore do të fillojnë nga paneli elektrik dhe do të shpërndahen nëpër pika të ndryshme të kontenierit.
- Kabllot do të drejtohen në mënyrë të organizuar për të shmangur mbivendosjet dhe për të siguruar qasje të lehtë në rast mirëmbajtjeje.
- Do të përdoren **kablllo NYY ose FG7** të përshtatshme për instalime të jashtme në mjedis të thatë
- **Vendosja e pajisjeve:**
 - Pajisjet (lavatriçet, tharëset dhe bojleri) do të jenë të gjitha të vendosura brenda kontenierit sipas planit të optimizuar për funksionalitet dhe siguri.
 - Çelësat e ndriçimit do të pozicionohen pas derës për lehtësinë e përdorimit.

Shpërndarja e ngarkesës (propozuar):

Pajisja	Fuqia	Lidhja	Faza e sugjeruar
Lavatriçe 1	2 kW	1F – 230V	L1
Lavatriçe 2	2 kW	1F – 230V	L2
Lavatriçe 3	2 kW	1F – 230V	L3
Tharëse 1	2.5 kW	1F – 230V	L1
Tharëse 2	2.5 kW	1F – 230V	L2
Bojler	2 kW	1F – 230V	L3
Aspirator	200 W	1F – 230V	L2
Ndriçimi (LED)	50 W	1F – 230V	L1
Priza shërbimi	4x0.5kW	1F – 230V	L1 / L2 / L3
Lavastovilje 1	2 kW	1F – 230V	L2
Lavastovilje 2	2 kW	1F – 230V	L3

Totali ≈19.25 kW

Llogaritja e rrymës:

$$I_{faze} = \frac{P}{V \cdot pf} = \frac{19250w}{\sqrt[3]{400 \cdot 0.95}} \approx 29.2A$$

Pra, ngarkesa do të ndahet në mënyrë të balancuar, me rreth **29 A për fazë**.

Komponentët e kuadrit trefazor :

Elementi	Specifikimi
Llamp sinjalizimi	3 fazore
Ndërprerës kryesor	4P – 40 A
Diferencial trefazor	4P – 30 mA, 40 A
Siguresa për lavatriçe/tharëse/lavastovilje	16 A (secila)
Siguresa për bojler	16 A
Siguresa për ndriçim	6 A
Priza shërbimi	2x16 A
Kabllo furnizimi	5x6 mm ² ose 5x10 mm ² (sipas distancës)